



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 02.06.2023

Nr: 172

Ora: 10:20

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 71, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "BINDJA DEMOKRATIKE"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 02.06.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor "Bindja Demokratike"

OBJEKT: Rinumërim i kutive për QV nr. 0522, 0473, 0476, 0477 dhe 0499 për këshillin bashkiak Tropojë, si dhe ndryshimi i Tabelës Përmbledhëse sipas rezultatit të dalë nga rinumërimi.

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Bindja Demokratike” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 71 regj., datë 22.05.2023.

Në seancën e datës 30.05.2023, KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta, duke ia qartësuar palës ankimuese se duhet të referojë vendimin objekt ankimi, sipas shkronjës “b”, pika 1 të nenit 126, si dhe të bashkëlidhë provat ku mbështeten pretendimet, sipas shkronjës “dh”, pika 1 të nenit 126.

Me anë të vendimit nr. 168, datë 30.05.2023, KAS vendosi kthimin e kërkesës ankimore për plotësim të elementeve të formës, me një afat 24 orë.

Në mbledhjen e datës 02.06.2023, ora 10:20, pas relatimit të z. Koli Bele u konstatua dhe u pohua nga administrata e KQZ-së se subjekti ankues nuk e kishte ridepozituar kërkesën ankimore të korrigjuar, sipas përcaktimeve të bazuara në Kodin Zgjedhor, që KAS orientoi në seancën e shkuar.

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe nenit 129 pika 3 shkronja “b” të Kodit Zgjedhor kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 71, datë 22.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Bindja Demokratike”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të tij.

Koli	BELE	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar